

LIBERALIZIMI I TREGUT TË ENERGJISË: 1,294 KOMPANI TË OBLIGUARA TË ZGJEDHIN VET FURNIZUESIN NGA QERSHORI 2025

Oda Ekonomike e Kosovës

KESCO si Furnizues me Energji Elektrike, njofton se që nga data 1 qershor 2025, me kërkesë të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), të gjithë konsumatorët komercialë që kanë qarkullim vjetor më të madh se 10 milionë euro, ose më tepër se 50 punëtorë do të dalin në treg të hapur, pra do ta kenë të obligueshme ta zgjedhin vet furnizuesin.

Sipas analizës së Odës Ekonomike të Kosovës, bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), 1,294 kompani i plotësojnë kriteret e përcaktuara, nga të cilat 761 kanë mbi 50 punëtorë, 318 realizojnë qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro, dhe 215 i përmbushin të dyja kriteret.

Analiza sipas strukturës së aktiviteteve tregon se nga 1,294 kompani që plotësojnë kriteret, sektori më i prekur është Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, me 438 kompani (33.8%), i ndjekur nga Prodhimi me 197 kompani (15.2%), Ndërtimtaria me 95 kompani (7.3%), Aktivitetet financiare dhe të sigurimit me 71 kompani (5.5%) dhe Informacioni dhe Komunikimi me 67 kompani (5.2%).


Përgatitur nga: Oda Ekonomike e Kosovës, Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Burimi: ATK


Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org

Numri i kompanive që do të dalin në treg të hapur



Numri i kompanive sipas aktiviteteve me mbi 50 të punësuar, mbi 10 milion euro qarkullim dhe me dy kriteret (>50 punëtor dhe >10milion)



Gjithsej kampani sipas aktiviteteve me mbi 50 të punësuar, mbi 10 milion euro qarkullim dhe me dy kriteret (>50 punëtor dhe >10milion)

